

VENDIM
Nr. 503, datë 17.7.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS SË FSHATIT MUÇAJ (UNAZA)”, NË BASHKINË VORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstrukcion i rrugës së fshatit Muçaj (Unaza)”, në Bashkinë Vorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “tokë bujqësore”, me sipërfaqe 564 m², me vlerë të përgjithshme prej 252 672 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 252 672 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Vorë, planifikuar në buxhetin e saj, me vendim të Këshillit Bashkiak.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe të përfundojë tre muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur pranë Bashkisë Vorë certifikatën e pronësisë, hartën treguese të regjistrimit si dhe kartelën e pasurisë.

8. Afati i përfundimit të punimeve, të objektit në Bashkinë Vorë, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vorë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar, në favor të Bashkisë Vorë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit:
“Rikonstruksion i rrugës së fshatit Muçaj (Unaza)”
Bashkia Vorë

Nr	Emri, Mbiemri (Pronari që shpronësohet)	Zona Kadastrale	Lloji i pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja e prekur/m²	Çmimi i tokës bujqësore/ lekë/m²	Vlera e përgjithshme e shpronësimit	Shënime
1	Xhaferr Hariz Muça	2726-Muçaj	"tokë bujqësore"	18/44	400	448	179,200	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Dylaver Hysen Shpati	2726-Muçaj	"tokë bujqësore"	45/5	100	448	44,800	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Kolec Geg Biba	2726-Muçaj	"tokë bujqësore"	45/3	64	448	28,672	Konfirmuar nga ZVRPP
	Shuma				564		252 672	